



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Integrimin European

PROCESVERBAL

Tiranë, më 28.01.2019, ora 11:00

Drejton mbledhjen:

Genc Pollo – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 13.12.2018
2. Miratimi i kalendarit të Komisionit të Integritimit European për periudhën 21 janar – 8 shkurt 2019
3. Shqyrtimi i projektligjit “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 64, datë 31.05.2012 “Për peshkimin”, të ndryshuar””.
4. Çështje të tjera.

Marrin pjesë:

Genc Pollo, Senida Mesi, Fatmir Velaj, Taulant Balla, Mirela Kumbaro, Fatmir Velaj, Ilir Pendavinji, Arben Kamami, Klodiana Spahiu, Aldo Bumçi, Rudina Hajdari, Jorida Tabaku, Musa Ulqini, dhe Viktor Tushaj.

Mungojnë:

Sadri Abazi, Vangjel Dule, Grida Shqina

Të ftuar:

Roland Kristo – Zëvendësministër i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

Arian Palluqi – Përgjegjës i Sektorit të Politikave dhe Strategjive të Zhvillimit në fushën e Peshkimit dhe Akuakulturës

HAPET MBLEDHJA

Genc Pollo – Fillojmë mbledhjen e komisionit tonë, duke ju uruar të gjithëve mbarësi në vitin 2019!

Vërejmë se në komisionin tonë kemi dy anëtare të reja, të cilët plotësojnë postet vakante të krijuara në të, zonjën Senida Mesi, që është edhe nënkryetare e komisionit, si dhe zonjën Mirela Kumbaro, që është anëtare e komisionit.

Ju uroj mirëseardhjen!

Në mbledhjen e sotme kemi shqyrtimin, ndër të tjera, edhe të kalendarit të komisionit, i cili ju është shpërndarë, ku kemi dy çështje, projektligjin “Për peshkimin”, që do të shqyrtohet ditën e sotme. Këtu janë përfaqësuesit nga ministria përgjegjëse, ndërsa në datën 4 do të kemi projektligjin “Për Agjencinë e Rojës Bregdetare”, një marrëveshje ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Europian.

Besoj se mund të biem dakord me datat, por lidhur me orarin e mbledhjes, si nga përvoja e sotme, ashtu edhe nga bisedat me kolegët, na lind një problem që, duke qenë se anëtarët e komisionit tonë janë anëtarë të komisioneve që mbledhen edhe më shpesh, na konfliktojnë oraret.

Një sugjerim që e diskutuam në kryesi për të pasur një operim pa pengesa të punës sonë, por edhe të komisioneve të tjera, është që, si rregull, mbledhjet tona t’i bëjmë në mesditë ose rreth orës 12:00. Po t’i lëmë një orë, 60 minuta para ose prapa, gjithmonë mund të krijojmë ngërçe, siç pamë edhe sot, ndaj besoj se ora 12:00 është e pranueshme për punën tonë, pasi mbledhjet tona jo gjithmonë zgjasin, siç mund të jenë të komisioneve të tjera, të cilat kanë një ngarkesë legjislative më të madhe se komisioni ynë.

Në qoftë se biem dakord, mund ta vendosim si rregull që të mbledhemi rreth kësaj ore, ndërkohë që data e mbledhjes caktohet në kalendar dhe përgjithësisht është një nga tri ditët e para të javës, kryesisht e hëna dhe e marta.

Ka ndonjë mendim për sa thashë? Nuk ka.

Atëherë, para se të futemi në rendin e ditës, që është projektligji “Për peshkimin”, krahas miratimit të procesverbalit dhe të kalendarit, kemi diskutuar me disa kolegë, fillimisht nga opozita, pastaj edhe në kryesi, që të kërkojmë informacion lidhur me ecurinë e punës së qeverisë në përmbushjen e kritereve dhe kushteve të vendosura nga Bashkimi Europian.

Ju kujtoj që, sipas ligjit, çdo tre muaj qeveria është e detyruar t’i paraqesë Kuvendit, specifikisht komisionit tonë, një raport për masat e marra në përmbushje të detyrimeve. Raporti

i tremujorit të fundit të vitit të kaluar nuk ka ardhur ende në Kuvend, madje as në komisionin tonë.

Ne kemi një traditë: kemi rënë gjithnjë dakord për t'i dërguar qeverisë kërkesa specifike, gjithmonë brenda kuadrit që përmenda, përkatësisht që e mbulon këtë gjë, dhe besoj se materiali ju është qarkulluar.

Së pari, që ta sqarojmë, Kuvendi, maxhoranca e tij, ka votëbesuar si ministër për Europën dhe Punët e Jashtme zotin Edi Rama. Pra, pavarësisht nga çfarë mund të ndodhë brenda ekzekutivit, Edi Rama mbetet ministri përgjegjës për çështjet e integritit europian. Kërkesat për informacion që ne dërgojmë në emër të komisionit tonë janë si vijojnë, po i lexoj të gjitha që, në qoftë se keni ndonjë ide për të shtuar ose për të plotësuar, mund t'i shprehni.

“1. Informacion të përmbledhur për çështjet: ecuria e detyrave të përcaktuara në përfundimet e Këshillit të Bashkimit Europian në qershor të vitit 2018; ecuria e zbatimit të pesë prioritetëve kyçe për hapjen e negociatave të anëtarësimit.

2. Informacion për plotësimin e strukturës negociatore dhe planet për trajnimin e tyre: ecuria e procesit *screening* dhe kalendari i caktuar i takimeve.

3. Raporti i tremujorit të fundit për vitin 2018, që e përmenda, kalendari i takimeve me Këshillin, komitetet dhe nënkomitetet e Stabilizim-Asociimit për vitin 2019, si dhe lista e ligjeve që përafrojnë legjislacionin europian të parashikuar për shqyrtim gjatë vitit 2018 dhe sa prej tyre nuk janë realizuar gjatë vitit të kaluar”. Kjo është pak a shumë lista e pyetjeve që përputhet në tërësi me kërkesat për informacion që kemi bërë më herët, por mund të ketë shtesa dhe specifikime lidhur me situatën konkrete, në të cilën ndodhemi pas vendimit të Këshillit Europian qershorin e vitit të kaluar.

Ka diskutime lidhur me këtë kërkesë për informacion?

Taulant Balla – Me leje?

Genc Pollo – Po, zoti Balla.

Taulant Balla – Së pari, më lejoni ta përgëzoj opozitën për rikthimin në punën normale të komisioneve të Kuvendit dhe të seancave plenare, pasi kjo është një gjë shumë e mirë, por po aq i mirë dhe i mirëpritur është roli monitorues që ka opozita përkundrejt qeverisë në detyrën që ajo ka. Sigurisht, në këtë kontekst, rol tejet të rëndësishëm merr edhe Komisioni për Integrimin Europian.

Jam plotësisht dakord me kërkesën që ju keni bërë, pavarësisht se dua ta them që në fillim se, sot që flasim, jemi në datën 28 janar dhe, në bazë të ligjit “Për rolin e Kuvendit të Shqipërisë në procesin e integritit europian të Shqipërisë”, një ligj shumë i rëndësishëm i bërë

me kontributin e vyer të opozitës ose, le të themi, të zonjës Bregu në legjislaturën e kaluar, së bashku me mua dhe kolegë të tjerë të Komisionit të Integritetit Europian, qeveria ka për detyrë që në fund të muajit shkurt të sjellë raportin e përgjithshëm vjetor për të gjithë punën e bërë përgjatë gjithë vitit 2018, i cili duhet të shoqërohet me një diskutim të gjerë jo vetëm këtu në komision, por edhe në një debat në seancë plenare, pasi unë mendoj që jemi në kohën e duhur për t'u fokusuar të gjithë së bashku në këtë proces të realizimit të aspiratës historike të të gjithë shqiptarëve, sikurse është anëtarësimi në Bashkimin Europian.

Kështu që, unë do të doja që kërkesa juaj, tërësisht e bazuar në Rregullore, të jetë komplementare me parashikimet që bën ligji “Për rolin e Kuvendit të Shqipërisë në procesin e integritetit europian të Shqipërisë”, pra pa i ndarë, duhet që raporti që sjell qeveria, raporti vjetor do ta quaja unë, të jetë shumë më i thellë dhe më gjithëpërfshirës sesa specifikimet që ju keni bërë me të drejtë.

E para, duhet të dimë të gjithë se ligji “Për statusin e deputetit” ia jep të drejtën çdo deputeti, në fakt, që të kërkojë shpjegime, jo më kur bëhet fjalë për kryetarin e komisionit ose komisionin në tërësi. Por duke qenë se kemi hyrë tashmë në fazën e dymujorit të parë të vitit, kur qeveria e ka detyruese nga Kuvendi të sjellë raportin vjetor, do t'ju kërkoja që të dyja këto gjëra të jenë komplementare. Kërkesa le të niset, ndërkohë që Komisioni i Integritetit Europian i kujton qeverisë detyrimin që ka për të respektuar afatin.

Në detyrën tjetër që unë mbaj, atë të kryetarit të grupit parlamentar të shumicës, do të diskutoj me dy kryetarët e tjerë të grupeve parlamentare, qoftë me zotin Spaho, qoftë me zotin Vasili, edhe me zotin Mediu, për shkak se edhe ai ka një grup parlamentar, të paktën në letra, që të parashikojmë në Konferencën e Kryetarëve edhe zhvillimin e një debati kuvendor lidhur me këtë çështje. Pra, shpreha dakordësinë për propozimin tuaj që të hyjmë në prerogativat e përcaktuara nga ligji përkatës.

Genc Pollo – Po, zoti Bumçi.

Aldo Bumçi – Zoti kryetar, unë kam një sugjerim. Mendoj se do të ishte me shumë vlerë t'i shtojmë edhe një kërkesë tjetër listës, pasi në procesin e integritetit europian Bashkimi Europian ka vendosur si kusht edhe marrëdhëniet e mira me fqinjët, qoftë të sigurisë rajonale, pra si pjesë e rëndësishme e integritetit të një vendi apo të rajonit.

E para, është në interesin e të gjithë shqiptarëve, në Shqipëri dhe në Kosovë, që të dimë se cili është qëndrimi i Kryeministrit Rama për propozimin për shkëmbime territori apo korrigjim kufijsh, që është hedhur në dialogun ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Pra, është interesi ynë.

E dyta, duke ditur që Gjermania, vendi më i rëndësishëm i Bashkimit European, është qartazi, prerazi, kundër kësaj nisme, pra se kancelarja Merkel ka dalë qartësisht kundër një propozimi, që është antieuropean, pasi nuk pasqyron vlerat europiane të pasluftës së Dytë Botërore, atëherë Kryeministri duhet ta sqarojë këtë gjë, sepse nuk mund të ketë hapje negociatash kur ne bëjmë propozime antieuropiane, që do të hapnin “kutinë e Pandorës” në të gjithë rajonin tonë.

Faleminderit!

Genc Pollo – Mendoj se sugjerimi i zotit Bumçi mund të shtohet në listën e kërkesave për informacion, ndoshta formulimi ka nevojë të bëhet në mënyrë të saktë dhe të plotë, që të jetë e qartë për Ministrinë për Europën dhe Punët e Jashtme, por kjo ka të bëjë me qëndrimin zyrtar të qeverisë në raport me propozimet apo sugjerimet e bëra për ndryshim kufijsh apo shkëmbim terriroresh, siç e kuptova unë propozimin.

Fjalën e ka nënkryetarja, zonja Mesi.

Senida Mesi – Përshëndetje të gjithëve!

Së pari, dëshiroj që në këtë komision, sigurisht duke marrë parasysh edhe momentin ku është Shqipëria, duke pasur parasysh që këta pesë muaj edhe për qeverinë shqiptare, edhe për maxhorancën, janë shumë të rëndësishëm në lidhje me raportin që presim në qershor të këtij viti, shprehem dakord në parim me të gjitha kërkesat, pasi janë të ligjshme, dhe, sigurisht, është punë dhe detyrë funksionale e këtij komisioni.

Për hir të specifikave, duke marrë parasysh se një nga pikat është raportimi që kërkohet në lidhje me pesë prioritetet, ku vetë Ministria për Europën dhe Punët e Jashtme do t’u kërkojë informacion edhe ministrive të tjera që mbulojnë pesë prioritetet, do të kërkoja, nëse është e mundur, ta shtyjme afatin edhe me një javë ose le të themi nga 15 janari, për t’i lënë kohën e mjaftueshme Ministrisë për Europën dhe Punët e Jashtme për të dakordësuar dhe për të mbledhur informacionin nga ministritë e tjera, me qëllim që informacioni të na vijë i plotë, duke pasur të gjithë njëherazi hapësirën për ta diskutuar në detaje.

Faleminderit!

Taulant Balla – Edhe një herë, ju lutem, se ndoshta nuk e sqarova qartë.

Në bazë të ligjit të përmendur më parë, në nenin 18 “Raportimi në Kuvend” thuhet: “Këshilli i Ministrave deri më 31 janar të çdo viti paraqet në Kuvend një raport të detajuar mbi zbatimin e detyrimeve sipas planit kombëtar për integrimin European, ecurinë e procesit të bisedimeve për anëtarësim dhe menaxhimin e fondeve nga Bashkimi European dhe donatorë të tjerë për vitin paraardhës. Raporti shqyrtohet në seancë plenare, në përfundim të së cilës

Kuvendi miraton rezolutën përkatëse”. Po ashtu, duke qenë se jam bashkëhartues i këtij ligji, aty thuhet se (kur brenda datës 31 janar depozitohet), brenda tri javëve zhvillohet edhe seanca plenare me debat për këto çështje dhe në përfundim të seancës miratohet rezoluta. I vetmi instrument që ka Kuvendi është rezoluta, që është detyruese për t’u ndjekur nga institucionet që janë në varësi të tij. Kujtoj këtu që Kuvendi ka një rol drejtues në këtë proces.

Pra, shumë mirë që sot më 28 janar nisim jo vetëm me këto, por edhe me hallin që ka zoti Bumçi apo kushdo tjetër, por të gjitha këto janë pjesë e këtij raporti për të cilin unë jam i bindur se qeveria do ta respektojë afatin, që është e enjtja e kësaj jave.

Unë propozova që pavarësisht se çfarë kërkohet, këto që kërkoni ju janë të gjitha pjesë të raportit dhe nuk janë vetëm për 3 muajt e fundit, por janë për të gjithë vitin. Megjithatë, propozimi juaj nuk kundërshtohet, por është i miratuar *fait accompli*, është e drejta juaj. Për të qenë seriozë në ato që propozojmë dhe kërkojmë, them se që nga ky moment grupet parlamentare duhet të fillojnë të marrin përgjegjësitë për përgatitjen e një debati konstruktiv dhe të plotë në lidhje me këtë çështje.

E dyta, që dua të them është se pavarësisht se çfarë merakesh kanë, qëndrimi zyrtar i qeverisë shqiptare për çështjen që preku zoti Bumçi, është shumë i qartë. Shqipëria në mënyrë të njëtrajtshme ka mbështetur dhe mbështet dialogun mes shtetit të pavarur dhe sovran të Kosovës me shtetin e Serbisë. Këtu fillon dhe këtu mbaron i gjithë diskutimi për këtë çështje, sepse në asnjë rast ne nuk mund të jemi pjesë e ndërhyrjeve në politikën e jashtme të shtetit të pavarur dhe sovran të Kosovës. Për sa kohë që në këtë proces është përfshirë BE-ja përmes Komisioneres për Politikën e Jashtme dhe Sigurinë, zonjës Mogerini, për sa kohë që të gjitha vendet anëtare të BE-së e mbështesin këtë proces, sigurisht edhe Shqipëria jonë e mbështet.

Megjithatë, jemi shumë të hapur që edhe kjo të jetë pjesë e këtij debati që do të zhvillohet në Kuvendin e Shqipërisë me të gjitha diskutimet dhe me të gjitha këndvështrimet përkatëse.

Zoti kryetar, unë do të kërkoja që Komisioni i Integritetit t’i drejtohet Konferencës së Kryetarëve me qëllim parashikimin e këtij debati në seancë.

Genc Pollo – Zonja Gjoshaj.

Klajda Gjoshaj – Unë besoj se është e drejtë e Komisionit të Integritetit të kërkojë raporte të njëpasnjëshme për çdo çështje ku ka paqartësi, aq më shumë për raportimet në këto momente, kur kemi edhe ndërrim të ministrave. Pavarësisht se ligji ia jep të drejtën Ministrisë për Europën dhe Punët e Jashtme të raportojë brenda datës 31 janar, ligji i ka qartësuar kërkesat që ka mbi këtë raportim.

Ndoshta në kërkesën tonë mund të shtojmë edhe filozofinë, politikën që do të ndiqet deri në çeljen e negociatave në qershor dhe pse jo, të parapërgatitet edhe një ftesë për ministrin për Europën dhe Punët e Jashtme për të raportuar në komisionin tonë. Kështu, unë besoj se kjo kërkesë mund t'i shtohet pikërisht asaj kërkesë ligjore dhe zyrtare që do t'i dërgohet për ministrit për Europën dhe Punët e Jashtme. Kjo e bën atë plotësisht legjitime dhe besoj se e tejkalon edhe atë që do të raportohet në datën 31 janar.

Unë besoj zoti kryetar, se kjo kërkesë është plotësisht legjitime dhe ne mund të shtojmë disa kërkesa të tjera se çfarë do të ndodhë, se cila është puna përgatitore që po merr përsipër ministria deri në qershor, kur do të kemi edhe një vendim të mundshëm nga Këshilli European.

Genc Pollo – Faleminderit!

Atëherë, biem dakord me shtesën e propozuar nga zoti Bumçi, i cili së bashku me këshilltarin e komisionit do të përgatisë formulimin shtesë.

Kam 2 komente për sa u tha.

E para, si praktikë e komisionit tonë ka qenë thirrja në dëgjese e të gjithë anëtarëve të qeverisë që kanë përgjegjësi për integrimin european. Kjo ka ndodhur pasi ata individualisht si ministra, apo si ministri e përgjithshme e linjës (Ministria e Integritimit, tani Ministria për Europën dhe Punët e Jashtme), kanë paraqitur një raport dhe në këtë rast, ne po presim edhe raportin vjetor që duhet të depozitohet së afërmi në Kuvend. Kërkesat specifike të paraqitura kanë të bëjnë edhe me punën konkrete që do të bëhet nga janari dhe në të ardhmen. Ne duhet të parashikojmë mbasi të na vijë përgjigjja me shkrim, një kalendar me dëgjesa konkrete. Kështu, në këtë moment ne do të hartojmë data të caktuara për dëgjesat, ku do të thirret ministri për Europën dhe Punët e Jashtme, ministrat e tjerë dhe zyrtarët përgjegjës, që do të diskutojnë.

Ne kemi një praktikë, por duke u bazuar në përgjigjet me shkrim është më e dobishme që të flasim të informuar, pasi të kemi lexuar raportimet e shkruara të tyre. Unë besoj se këtë praktikë do ta vijojmë në të ardhmen. Nga shkurti e tutje do të fillojmë ta planifikojmë.

Lidhur me rezolutën që do të miratohet, siç e kërkon ligji, unë do të doja t'u kujtoja se vitin e kaluar është krijuar një precedent negativ, që e kemi diskutuar edhe në komision. Ka qenë një mbledhje pak e tensionuar, sepse diskutohej çështja e zotit Xhafaj. Ligji thotë se raporti i qeverisë, së bashku me projektrezolutën e propozuar nga qeveria i vjen Kuvendit. Kjo nuk do të thotë se ajo i kalon në mënyrë direkte, urgjente dhe imediate seancës plenare, siç

fatkeqësisht u veprua në mes të vitit të kaluar. Kuvendi përbëhet nga komisionet dhe komisioni ynë është komisioni përgjegjës për këtë çështje.

Praktika e mirë e stabilizuar prej kohësh, që fatkeqësisht u thye vitin e kaluar, është që iu kalua direkt seancës plenare dhe nuk iu la mundësi as komisionit tonë, as komisioneve të tjera për dhënie mendimi që të shqyrtohej raporti dhe të diskutohej mbi të, sidomos të shikohej rezoluta dhe të bëheshin plotësime, korrigjime, saktësime, gjë që është bazë në përvojën parlamentare. Shpresoj të kthehemi në traditën pozitive dhe të mos kemi qarqe të shkurtra, si ai që vërejtëm herën e fundit.

Taulant Balla – Nuk e sjell qeveria projektrezolutën, por e formulon Kuvendi. Atë do ta bëjmë ne, si komision.

Genc Pollo – Po, por fatkeqësisht, vitin e kaluar rezoluta...

Taulant Balla – Edhe atë nuk e ka sjellë qeveria.

Genc Pollo – Fatkeqësisht, vitin e kaluar nuk u shqyrtua në komisione, nuk pati mundësi debati në komisionin tonë. Raporti kaloi drejt e në seancë plenare pa u shqyrtuar nëpër komisione. Në këtë mënyrë kalojnë vetëm dekretet e Presidentit, që kanë të bëjnë me emërimet dhe me shkarkimet. Të gjitha aktet e tjera që vijnë nga qeveria apo nga instancat e tjera, i nënshtrohen shqyrtimit nëpër komisionet përkatëse dhe këto komisione dihen dhe përcaktohen, kur nuk janë të qarta.

Besoj se deri këtu u morëm vesh.

Tani miratojmë procesverbalin e mbledhjes së mëparshme dhe kalendarin e punës, siç është paraqitur.

Kalojmë në shqyrtimin e projektligjit “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 64, datë 31.05.2012 “Për peshkimin”, i ndryshuar””.

Janë të pranishëm zoti Roland Kristo, zëvendësministër i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe zoti Arian Palluqi, përgjegjës i Sektorit të Politikave dhe Strategjive të Zhvillimit në Fushën e Peshkimit dhe Akuakulturës në këtë ministri, si dhe zotin Dedë Kasneci nga Njësia e Përafrimit të Legjislacionit e Kuvendit, i cili shikon çdo ligj nëse është në përputhje me MSA-në dhe *Acquis communautaire*.

Atëherë, i jap fjalën përfaqësuesit të ministrisë për të prezantuar nismën e tyre legjislative.

Urdhëroni!

Roland Kristo - Përsëritje të gjithëve!

Ne sot po prezantojmë projektligjin “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 64, datë 31.05.2012 “Për peshkimin”, i ndryshuar””. Ky është një ligj modern, që bazohet në disa rregullore të Këshillit të Europës dhe të Komisionit European. Ndryshimi kryesor që po propozojmë sot është, sepse një nga këto rregullore është shfuqizuar nga Këshilli i Europës dhe ne natyrisht, e kemi reflektuar këtë në ligjin tonë “Për peshkimin”. Kjo ka të bëjë me pjesën e mënyrës së organizimit dhe qartësimit të kompetencave të organizatave të peshkimit, rezoluta prodhuese dhe atyre të menaxhimit.

Në thelb ndryshimet e propozuara bëjnë vetëm këtë pjesë transpozimi. Gjithashtu, në ligj janë bërë disa rregullime të tjera të vogla, që kanë të bëjnë me mënyrën e rregullimit të peshkimit të vogël, artizanal, bregdetar, pasi mënyra se si është rregulluar sot ky lloj aktiviteti, është e vështirë për t’u kontrolluar. Fakt është sot që në çdo fshat, në çdo pikë të bregdetit është dikush që del e peshkon me një barkë. Kjo kërkon natyrisht një kontroll dhe një mbrojtje kapilare, gjë që i rrit në mënyrë të ndjeshme kostot e monitorimit të aktivitetit të paligjshëm të peshkimit.

Ne kemi propozuar këtu që bregdeti të ndahet në disa zona, pavarësisht se nuk është specifikuar saktë, por kjo do të jepet në format e organizimit, pra shkon në organizatat e peshkimit dhe ato prodhuese. Një pjesë e bregdetit do të menaxhohet bashkërisht me grupet e interesit. Në këtë formë bregdeti shqiptar do të ndahet në 5-7 zona. Kjo do të varet nga diskutimet që ne do të bëjmë me grupet e interesit. Kjo zonë e caktuar, me një numër të përcaktuar mjetesh lundruese, do të menaxhohet së bashku me grupet e interesit, me ministrinë dhe me organet ligjzbatuese.

Këto janë ndryshimet. Nuk ka ndryshime të tjera. Të tjerat janë më shumë saktësime të ligjit ekzistues.

Faleminderit!

Genc Pollo – Faleminderit!

Kisha një pyetje. A e ka shqyrtuar këtë projektligj komisioni përgjegjës?

Akoma jo?

Urdhëroni, zoti Kasneci për të prezantuar mendimin e njësisë suaj për projektligjin!

Dedë Kasneci – Faleminderit, zoti kryetar!

Sikurse u tha nga përfaqësuesi i qeverisë, projektligji “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 64, datë 31.05.2012 “Për peshkimin”, i ndryshuar””, është përafruar pjesërisht me 2 akte në fushën e peshkimit dhe konkretisht me:

- Rregulloren e Këshillit nr. 1379/2013/BE, datë 11 dhjetor 2013 të Parlamentit European dhe të Këshillit, në lidhje me organizimin e përbashkët të tregjeve të prodhimeve të peshkimit dhe akuakulturës;

- Me Rregulloren nr. 508/2014/BE, të Parlamentit European dhe të Këshillit, i cili parashikon instrumentin financiar të politikës së përbashkët të peshkimit dhe konkretisht mbi Fondin European Detar dhe të Peshkimit.

Shërbimi ynë e ka analizuar përputhshmërinë e projektligjit të paraqitur me legjislacionin dytësor të BE-së. Ne kemi bërë 3 sugjerime me qëllim një përafrimin më korrekt dhe më të saktë. Është vërejtja e zakonshme e CELEX-it në fund të faqes, që lidhet me titullin e projektligjit. Kjo duhet saktësuar.

Janë edhe 2 vërejtje të tjera, që nuk janë thelbësore, por ne i kemi dakordësuar edhe me përfaqësuesit e qeverisë.

Faleminderit!

Genc Pollo – Faleminderit!...

Ka pyetje nga kolegët?

Fjalën e ka zonja Gjoshë! Më pas zoti Bumçi.

Klajda Gjoshë – Dua t'i falenderoj zotërinjtë për prezencën e tyre sot këtu, por edhe për prezantimin e ndryshimeve të bëra në projektligj!

Jam dakord me zotin Kasneci që duhet të bëhen rregullimet e parashikuara për përafrimin e legjislacionit dhe tabelat e përputhshmërisë. Kështu që, besoj se edhe zotërinjtë do të bien dakord dhe do t'i sjellin ato të rregulluara.

Kam një pyetje. Është bërë një diskutim i gjerë për çështjen e peshkimit. Nuk e shikoj në ndryshimet e paraqitura në projektligj (do të ishte mundësi e mirë ta kishim sot si diskutim) çështjen e fikjes së disa aparaturave GPS gjatë kohës së peshkimit, gjë që përbën vepër penale. Kjo do të duhet të ishte e sanksionuar në ligj, sepse lë hapësira për trafikë apo kontrabanda të ndryshme që ndodhin gjatë fikjes së këtyre aparaturave. Besoj se është momenti i duhur për të bërë një ndryshim të mundshëm në ligjin e peshkimit.

Faleminderit!

Aldo Bumçi – Faleminderit!

Unë do të bëj një koment, por, gjithashtu, jam shumë i gatshëm të dëgjoj nëse ministria ka ndonjë projekt.

Në fushën e peshkimit ne kemi një kontrast të madh midis industrisë përpunuese të peshkut, ku janë bërë investime të mëdha dhe flotës së peshkimit. Flota jonë e peshkimit është

nga më primitivet. Mungojnë mjetet e reja lundruese që krijojnë pavarësi për të qëndruar gjatë në det, kurse nga industria përpunuese në Shqipëri ne kemi investime ku punësohen qindra njerëz. Për shembull, pothuajse e gjithë aëukja e Kroacisë merret në Shqipëri. Flota kroate e ka tregun e sigurt, por ndërkohë në Shqipëri nuk ka një flotë. Kjo industri eksporton në Europë dhe Japoni duke plotësuar të gjitha kriteret. Në vend që të krijojë një zinxhir punësimi në Shqipëri, furnizohet nga flota kroate, siç është rasti i aëukes.

Mjafton që modeli të merret nga Kroacia dhe ky investim (Kroacia këtë gjë e ka bërë përpara 10 vjetëve) do të krijojë të paktën 3 mijë vende pune në bregdetin shqiptar. Po të krijohet zinxhiri i punësimit me kantieret e mirëmbajtjes, paketimit, akullit dhe gjithëcka tjetër që lidhet me këtë industri, do të krijoheshin të pakën 3 mijë vende pune në sektorin e peshkimit. Ndërsa industria përpunuese është, flota është primitive. Çfarë është bërë në këto 6 vjet dhe a ka një projekt për të zhvilluar flotën tonë për t'i dhënë mundësi që të ketë mjetet moderne lundruese, siç e bënë kroatët para 10-15 vjetëve?

Faleminderit!

Taulant Balla – Në fakt, edhe unë e kam një pyetje, por në parantezë të gjithë asaj që tha zoti Bumçi, së pari, ia kemi marrë dorën që t'ia nxijmë faqen Shqipërisë në çdo gjë. Një sektor ku ka pasur ndryshime thelbësore gjatë viteve të fundit është sektori i peshkimit. Shpesh edhe këtu në Kuvend kemi diskutuar kuadër ligjor përmirësues për këtë sektor. Sektori i peshkimit e ka shumëfishuar kontributin e vet në prodhimin e brendshëm bruto në 4 vjetët e fundit. Sektori i peshkimit sot jo vetëm që ka rritur numrin e të punësuarve, por është një ndër eksportuesit ose një ndër zërat më të mëdhenj në eksportet shqiptare.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Të lutem!

Të mos bëjmë gabime kur themi që kroatët peshkojnë në detin tonë apo diçka tjetër ...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Të lutem, mos më ndërpre, sepse unë nuk të ndërpreva!

Të gjithë e dimë që kuotat i kemi të përcaktuara. Kuotat tona ne i ezaurojmë tërësisht. Nuk kemi asnjë nga kuotat e peshkimit që ne nuk e ezaurojmë. Të gjitha qeveritë e mëparshme duhet të pranojnë se kanë gabuar në përcaktimin e kuotave tona.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Të lutem zoti Ulqini, sepse po flas!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Faleminderit!

Kuotat e peshkimit janë të përcaktuara edhe në Marrëveshjen e Stabilizim-Asocimit. Le të jetë ky një leksion që, përpara se të fillojmë të negociojmë marrëveshjen për anëtarësim, të gjitha qeveritë të jenë më të vëmendshme, sepse kuotat janë negociuar gjatë viteve 2004, 2005, 2006, që do të thotë se kanë involvuar dy qeveri. Me rritjen e kapaciteteve të flotës së peshkimit shqiptar ne i tejkalojmë ... Mundësitë janë më të mëdha për kapacitetet që zëmë.

Në këtë funksion do të doja që, për efekt të informimit të komisionit, ndoshta zoti Kristo mund ta informonte komisionin se sa ka qenë kontributi në eksporte i produkteve të peshkimit në vitin 2013 dhe sa është sot. Gjithashtu, të sqarojmë kolegun Bumçi dhe këdo tjetër që flota nuk është detyrë e shtetit, edhe pse shteti ka për detyrë të krijojë kushte, por që prej vitit 1991 është private. Të paktën kështu e di unë.

Faleminderit!

Viktor Tushaj – Edhe unë dua t’i falenderoj përfaqësuesit e ministrisë për arsyetimin e këtij ndryshimi ligjor. Dua të bëj dy pyetje. Ndryshimi thelbësor në ligj është bërë për t’u dhënë mundësi të gjithë peshkatarëve artizanalë të peshkojnë në mënyrë më të kontrolluar. A është menduar për tregjet? Unë dëgjova zotin Kasneci, i cili tha se ligji parashikon edhe përmirësimin e infrastrukturës së tregtimit. Ku do ta çojnë peshkun këta peshkatarë artizanalë? Ka vite që diskutohet për ndërtimin e disa magazinave ku të gjithë peshkatarët do të depozitonin peshkun e kapur për të krijuar mundësinë e krijimit të një burse peshkimi, ashtu siç e kanë të gjitha vendet e Bashkimit Europian. Mendoj se në iniciativën tonë përfaqëse ligjore duhet të jetë edhe kjo.

Problemi i dytë imi është certifikimi. Shqipëria ka një bregdet jashtëzakonisht të pastër, por duke munguar laboratorit certifikues i vazhdimësisë të pastërtisë, ne nuk kemi mundësi që të eksportojmë peshkun e freskët në vendet e Bashkimit Europian. Unë e di që është tentuar disa herë të bëhet një punë e mirë për krijimin e këtyre laboratorëve, që certifikojnë peshkun që merret në bregdetin shqiptar, por akoma nuk është konkluduar për t’u dhënë siguri vendeve të Bashkimit Europian që ky peshk është i freskët, pra, është i pastër në bazë të këtyre certifikatave laboratorike, të cilat i mungojnë Shqipërisë.

Faleminderit!

Klodiana Spahiu – Përsëritje!

Së pari, dua të vlerësoj punën e bërë nga ministria, sepse ky projekt ka nisur prej disa kohësh dhe shpresoj që ta çojnë deri në fund ashtu siç e kanë nisur, sepse, për hir të së vërtetës, ne kemi qenë prezent në disa seanca dëgjimore, që janë bërë në qytetin e Durrësit, për peshkimin dhe kam dëgjuar debatet që bëhen midis peshkatarëve dhe përfaqësuesve të

ministrisë që janë bërë prej kohësh dhe tani vijmë me një produkt, që është pikërisht ky projektligj. Ishte shumë e nevojshme për t'u grupuar dhe për t'u bashkuar peshkatarët, të cilët nuk kanë mundësi të mëdha financiare për të blerë anije të mëdha, por që mund të bëjnë një lloj peshkimi në një lartësi të caktuar, siç janë edhe normat në bregdet.

Dua të pyes zotin zëvendësministër, edhe në bazë të seancave që janë bërë në qytetin e Durrësit, nëse keni arritur në një konkludim në lidhje se çfarë është arritur për krijimin e këtyre organizatave të peshkatarëve, në mënyrë që edhe ata të punojnë në mënyrë të ligjshme e të kontrolluar, sasia e peshkut që zihet dhe cilësia që tregtohet në tregjet e peshkimit, për të cilat është diskutuar shpeshherë, të jenë të kontrolluara. Insistoj për qytetet bregdetare, sidomos për qytetin e Durrësit, sepse peshkimi është një aset shumë i çmuar dhe ka qenë një nga profesionet më të hershme dhe vazhdon të trashëgohet në familje, sepse ka prindër që ua trashëgojnë djemve të tyre peshkimin. Edhe në shkollën profesionale ne kemi një degë të veçantë që merret vetëm me peshkimin dhe kjo është një gjë shumë e mirë për të ardhmen dhe për ato të rinj që duan të futen në këtë degë. Shpresoj që ky të jetë një ogur i mirë edhe për punësimin e të rinjve në qytetin e Durrësit, por edhe një mënyrë e mirë organizimi. Tregjet e peshkimit do të jenë një hap shumë pozitiv për të gjitha qytetet bregdetare.

Faleminderit!

Genc Pollo- Edhe unë kam dy pyetje, pastaj përfaqësuesit e ministrisë do të marrin fjalën për të na sqaruar për pyetjet e ngritura.

Shoh që në ligjin aktual ka një shtesë për sistemin e monitorimit të anijes me *Mobile Transceiver Unit*, të cilat realizojnë identifikimin e një anijeje, pozicionin e saj gjeografik, sepse një shqetësim i madh është se anijet e peshkimit përdoren edhe për trafikimin e mallrave të paligjshme. Dua të di nëse ky sistem monitorimi do të ketë kosto dhe a kanë mundësi ekonomike peshkatarët apo kooperativat e peshkimit për të përballuar një pajisje të tillë?

Pyetja e dytë lidhet me shqetësimet, kërkesat, ndonjëherë edhe protesta të peshkatarëve për çmimin e karburantit që përdorin për peshkim dhe kërkesat për subvencionim për ta bërë këtë ekonomikisht të përballueshme. Si është gjendja aktualisht dhe a ka ministria juaj plane për ta trajtuar këtë problem dhe në çfarë mënyre do ta trajtojë?

Faleminderit!

Roland Kristo – Faleminderit!

Së pari, lidhur me bluboksin, që shtroi zonja Gjoshë, Shqipëria në vitin 2011 instaloi bluboksin, i cili u bë nën mbështetjen e BE-së, por, fatkeqësisht, ky sistem pas vitit 2011 pati problematika me mirëmbajtjen e tij dhe në mars të vitit 2017 problematikat ishin aq të mëdha

saqë sistemi u detyrua të fikej dhe sot sistemi është fikur. Fikja e sistemit ishte për faktin se që nga viti 2012-2017 paratë e parashikuara për mirëmbajtjen e sistemit u përdorën për pagesën e sinjalit satelitor, i cili, sipas ligjit të peshkimit, duhet të paguhet nga anijet e peshkimit. Sistemi ngeli i vjetër, ndërkohë me kalimin e kohës edhe aparaturat u vjetëruan. Sot ky ndryshim i ardhur lidhet me emërtimin për të ndarë se çfarë është aparati bluboks (MTU-ja) dhe pjesa e sinjalit. Ne, si ministri, në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe me AKSHI-n gjatë vitit të kaluar parashikuam që aparati bluboks do të jepet falas nga ministria. Vitin e shkuar, për arsye tenderimi, ne nuk arritëm në kohë të mbyllim këtë procedurë dhe brenda 6-mujorit të parë është parashikuar që sistemi bluboks të rivihet në punë, ku aparatet do t'i paguajë ministria, ndërsa sinjalin do ta paguajnë anijet e peshkimit. Kjo është e përcaktuar në ligj dhe është formë që përdoret në pjesën më të madhe të vendeve të botës. Kostoja e sinjalit të kësaj shkon 25-30 euro në muaj për anije mbi 12 metra gjatësi, pasi anijet e tjera nuk kanë detyrim të pajisen me këtë aparat. Është njësoj si impulset e celularit që i paguan, ndërsa aparatin, duke qenë se është një mjet kontrolli, do ta paguajë shteti.

Genc Pollo – Këtë kosto kanë detyrim ta mbajnë peshkarexhat?

Roland Kristo – Po.

Ne jemi në kontakt të vazhdueshëm dhe presim që ky saktësim të bëhet në ligj, sepse AZHBR-ja nuk e përfshin këtë. Ne kemi pasur një debat me Ministrinë e Financave në lidhje me atë se çfarë paguan shteti dhe çfarë duhet të paguajnë anijet e peshkimit, prandaj e kemi bërë saktësimin, me qëllim që të shmanget pjesa e ndonjë keqkuptimi ose mosinterpretimi të saktë. VKM-ja nr.407 e vitit 2013 do të amendohet, sepse ky është një mjet kontrolli për zhvillimin e aktivitetit të peshkimit dhe aparatin do të vazhdojmë t'ua japim falas anijeve të peshkimit. Duhet të kemi parasysh se bluboksi nuk është një mjet për kontrollin e veprimtarive jashtë peshkimit, ai është një sistem i mbyllur, i cili monitoron aktivitetin e anijeve të peshkimit. Agjencitë e tjera ligjzbatuese mund të kenë akses, por nuk kanë për qëllim të shohin nëse po merret me kontrabandë apo me aktivitete të tjera.

Duhet të kemi parasysh një gjë, duke qenë se flota jonë do të ketë një aparat të caktuar të një modeli të caktuar dhe flota tjetër ka model tjetër, e cila nuk monitorohet nga qendra, në QNOD do të dalë vetëm një anije, por që në të vërtetë janë dy anije. Domethënë, ky nuk është një sistem kontrolli për pjesët e tjera ligjzbatuese, por shikohet pozicionimi, lloji i aktivitetit dhe, në rast se anija është duke kryer ose jo aktivitet të paligjshëm, verifikimin e bën në vend ose kur anija del në port. Në qoftë se një anije ndodhet pranë bregut, në një distancë më të vogël se 3 milje nga bregu dhe në QNOD shikohet se anija po ecën me 3,4 milje në orë, presupozohet

që është duke peshkuar. Gjobë nuk mund t'i vihet, sepse ajo mund të ecë edhe normalisht me 3,4 milje, por që ta vërtetojmë nëse është duke peshkuar ose jo duhet të shkojë roja bregdetare të shikojë nëse ka hedhur rrjetat ose kur del në port të shikohen llojet e peshqve që anija ka në bord. Nëse anija ka koce, levrek apo qefull, atëherë ka gjuajtur në breg dhe indicia që ka marrë QNOD-ja përputhet me produktin që ke nxjerrë në bankinë, atëherë vazhdohet me gjobën, por nuk shërben si provë për në gjyq që anija ka zhvilluar aktivitet të paligjshëm.

Sapo ligji të miratohet ...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Është e sanksionuar në vendimin nr.407. Ky sistem i ri është bërë i pamanipulueshëm nga peshkatarët, ndërsa sistemi që kemi pasur ka qenë me buton fik-ndiz, gjë që mund të krijojë panik nëse po i ndodh gjë anijes dhe është në rrezik mbytjeje. Sistemet e reja janë gjithë kohës të ndezur, nuk mund të manipulohen nga ana e peshkatarëve. Specifikimet teknike, të cilat nuk i kemi bërë ne, por janë bërë nën mbështetjen e FAO-s, kanë të futur logbook-un elektronik. Pra, në një të ardhme të afërt, kur BE-ja do ta ketë kusht, të dhënat e deklaramit të prodhimit të kapur do të bëhen nga anija e peshkimit. Për momentin ne nuk mendojmë të vendosim diçka të tillë, nuk do ta kërkojmë ndryshimin në ligj, por në vendim të Këshillit të Ministrave, sepse sinjali që dërgohet është sinjali i një mesazhi telefonik, 3 reshta kushtojnë 0,5 cent, 20 rreshta kushtojnë 3 euro, që do të thotë se është kosto dhe në këtë moment nuk mund ta fusim që deklarimin e prodhimit ta bëjnë nga anija me sistemin elektronik. Aparatura do të jetë e përshtatshme, e cila në të ardhmen me një monitor ose tabletë lidhet me aparaturën dhe bëhet sistemi pa ndryshuar aparatet.

Lidhur me açuken duhet të keni parasysh se açukja është lënda e parë për industrinë tonë përpunuese.

Ne për herë të parë vitin e kaluar nëpërmjet AZHBR-së futëm mbështetjen për peshkimin e açukes me 20 lekë për kilogram. Futja e këtij incentivi në mbështetje të flotës së peshkimit ka bërë që gjatë vitit të kaluar të jenë kapur sasitë më të mëdha të açukeve, sikurse janë bërë edhe investime në anijet e peshkimit, duke i kaluar në anije për peshkimin e pellagjikëve të vegjël. Duhet të kemi parasysh një gjë që nuk mund të peshkojmë pafundësisht açuke, pasi edhe vetë gjendja e açukeve në detin Adriatik të veriut dhe të jugut nuk është në kushte optimale dhe Komisioni i Përgjithshëm i Peshkimit të Mesdheut ka vënë disa kufizime deri në vitin 2021, pra ne nuk mund ta rritim sforcën e peshkimit tej disa parametrave të caktuar. Sidoqoftë, futja e incentivit prej 20 lekësh për kilogram ka bërë që peshkimi i açukes gjatë vitit të kaluar të ketë qenë në nivele rekorde, natyrisht do të vazhdojë edhe gjatë këtij viti.

Përpunimi i aqukes ka një problematikë tjetër. Shqipëria ka një kuotë eksporti me Bashkimin European. Kuota jonë është 1600 tonë në vit, mbi këtë kuotë paguhet taksë doganore 25%. Në momentin e miratimit të MSA-së ishte 1 mijë tonë, kur ne të kapnim 80% të shtohet me 200 tonë, duke arritur maksimumin 1600 tonë dhe tej asaj nuk mund të kalohej.

Fakt është se në të gjitha këto vite ka pasur tentativa, por jo zyrtare. Tentativat zyrtare janë bërë me letër zyrtare drejtuar qoftë komisionerit Hahn, qoftë **komisionerit Vela** gjatë vitit të kaluar. Në komitetin e mbajtur në muajin dhjetor midis Ministrisë së Bujqësisë dhe Komisionit European është kërkuar zyrtarisht rritja e kuotave të eksportit të aqukes.

Ky përbën një element kufizues në drejtim të eksporteve dhe është më shumë kufizues në drejtim të përpunimit të mëtejshëm të aqukes. Sot industria jonë përpunuese aqukën e çon si produkt final në vazo në vaji ulliri ose në vaj luledielli. Ky është produkti final. Në momentin kur ky produkt, kjo kuotë prej 1600 tonësh ezaurohet, industria jonë përpunuese peshkun e eksporton në qese vakuumi, pra të papërfunduar. Përfundimi i procesit ndodh në Itali ose në Spanjë, të cilat janë edhe dy tregjet kryesore. Pra, si thuash është një kufizim edhe për numrin e të punësuarve në sektor. Ne shpresojmë në rinegocim të kuotave, qoftë duke rritur kuotën, qoftë dhe duke mosllogaritur vajin në vazo. Në qoftë se heqim vajin, automatikisht kuota dyfishohet. Megjithatë, këto janë çështje negociatash që ne kemi filluar me Komisionin European. Shpresojmë që kjo të ecë, por nuk është një proces shumë i thjeshtë për faktin se një marrëveshje e tillë do të kërkojë në krahun tjetër që të bëjmë lëshime për produkte të tjera, që ne i kemi të mbrojtura ndaj produkteve të Bashkimit European.

Së dyti, marrëveshja duhet të miratohet nga të gjitha parlamentet e vendeve të Bashkimit European, pra është një proces i cili do të kërkojë kohë dhe nuk është i thjeshtë. Zyrtarisht, qoftë me shkresë, qoftë në mbledhjen e nënkomitetit është kërkuar zyrtarisht dhe është pjesë e procesverbalit dhe e minutave të takimit kërkesa e Shqipërisë për rritjen e kuotave të eksportit të aqukes. Nuk është vetëm aqukja, ne kemi eksportin e levrekut të industrisë së akuakulturës në bregdet, i cili e ka kuotën prej 50 tonelatash. Kjo sasi është me taksë doganore, por, fatmirësisht, taksa është 6%, po kështu është me sardelen, me skumin, pra me të gjitha prodhimet e tjera të industrisë përpunuese. Ne kemi taksë doganore mbi disa sasi, të vendosura në aneksin 3 të MSA-së.

Në lidhje me tregjet, natyrisht markatat e tregtimit me shumicë është pjesa që ne kemi filluar të merremi seriozisht. Ju jeni deputet i Lezhës dhe keni parë që ka filluar në Shëngjin ndërtimi i markatës së Shëngjinit. Markata e Shëngjinit është e para markatë e tregtimit të peshkut me shumicë që po ndërtohet në Shëngjin. Këtë vit kemi parashikuar edhe ndërtimin e

markatës në Vlorë, në Durrës në portin e ri të peshkimit është ndërtuar një markatë, por projekti është gabim. Në vend që të jetë e markatë e tregtimit me shumicë, është bërë markatë e tregtimit me pakicë. Kërkon pak ndryshime dhe ne, në bashkëpunim me peshkatarët, do ta kthejmë në një markatë të tregtimit me shumicë. Markata e tregtimit me shumicë është ajo që i jep vlerë të shtuar prodhimit dhe që rregullon raportet midis prodhuesit dhe tregtarit.

Në lidhje me peshkimin e vogël artizanal, që është pjesë e cilësisë së prodhimeve që ata hedhin, që ndoshta mund të jenë larg nga markatat kryesore, të cilat i kemi parashikuar në Shëngjin, në Durrës dhe në Vlorë dhe në Sarandë, ky është edhe një nga hapat që do të vazhdojmë, pas miratimit të ndryshimit në këtë projektligj.

Së pari, bregdeti do të ndahet në 5 ose 7 zona. Kjo është një çështje që do ta vendosin teknikët në nivel diskutimesh. Ne kemi filluar me Koperacionin Italian një census të të gjithë bregdetit shqiptar për të parë zonat ku janë më shumë të përqendruara varkat e vogla të peshkimit, pavarësisht se në pjesën e lejes së peshkimit është përcaktuar bregdeti i Divjakës. I gjithë procesi i formalizimit të mëtejshëm të këtij sektori do të shkojë me dy forma: më jep, të jap.

Natyrisht, formalizimit do t'i japim ngritjen e qendrave të voglat të grumbullimit, ku prodhuesit e vegjël do të nxjerrin produktet e tyre. Kjo është një pjesë që ne kemi parashikuar ta futim në kuadër të mbështetjes nëpërmjet ABZHR-së. Pra, do të jetë një proces që, duke shkuar drejt formalizimit, t'u japim në menaxhim qoftë pjesën bregdetit, qoftë pjesën e markatave të vogla të përpunimit të peshkut. Ne shembujt në Shqipëri i kemi. Për shembull, është rasti i Shkodrës, ku janë të organizuar vetë dhe kanë qendrën ku grumbullojnë peshkun.

Ne eksportojmë peshk të freskët dhe të përpunuar, kështu që çështja e certifikimit të prodhimeve më duket jo shumë ekzakt.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Në qoftë se flasim për peshkun, në muajin shtator kaluam auditin e Bashkimit European dhe ka qenë një raport audit... Zakonisht burokratët e Brukselit nuk para japim vlerësime pozitive, por thonë e ke plotësuar e ke plotësuar, por ka qenë një nga vlerësimet më të mira që ne kemi pasur, të paktën industria jonë përpunuese.

Genc Pollo – Që të jemi konkretë, sepse kemi dëgjuar për midhjet që për arsye X apo Y nuk na i pranoin për eksport në tregun e përbashkët, ku jemi me midhjet tani?

Roland Kristo – Në muajin dhjetor i kemi bërë kërkesë zyrtare *Digisante-s* për të bërë auditin për eksportin e midhjeve.

Genc Pollo – Kjo është për të ardhmen. Statusi aktual?

Roland Kristo – Statusi aktual është se midhjet kontrollohen nga ana e AKU-së dhe nga ana e shërbimit tonë veterinar. Për momentin ne nuk eksportojmë. Ajo që i kemi kërkuar Bashkimit European është që të vijë gjatë këtij viti për të bërë kontrollin dhe për të pasur mundësinë e eksportit. Fillimisht, nuk pretendojmë të eksportojmë të gjallë, kemi kërkuar për të eksportuar produkte...

Genc Pollo – Ku është problemi?

Roland Kristo – Problemi qëndron se AKU-ja nuk është e besueshme nga BE-ja. Ky është problemi. Nuk është problemi i produktit nëse është në këtë formë apo në atë formë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Genc Pollo – Ky është thelbi që na intereson edhe neve si komision, sepse të tjerat i keni te Komisioni i Ligjeve.

Urdhëroni!

Jorida Tabaku – A ka pasur një moment kur eksportohej midhja dhe u ndalua?

Roland Kristo – Që nga '94 nuk ka pasur. Natyrisht, duhet të kemi parasysh që, në fund të fundit, është një luftë tregtare.

Jorida Tabaku – A ka legjislacion që mund ta përafrojmë ne si komision për AKU-në, apo është thjesht licencimi i AKU-së?

Roland Kristo – Legjislacioni është i gjithë i përafëruar. Vetëm duhet të keni parasysh një gjë. Për shembull, ne jemi një vend që, natyrisht, nuk kemi sasi të mëdha, pra nuk ndikojmë mbi tregjet e Bashkimit European. Nga ana tjetër, për të bërë një analizë të caktuar kërkon 500 mijë euro, pra për një sasi që mund të jetë minimale analizash që do të na duhet të bëjmë. Tashmë ne e kemi zgjidhur me formë tjetër, pra një pjesë të analizave që nuk i bëjmë dot sot në Shqipëri i prokurojmë në laboratorë jashtë vendit, kryesisht të akredituar në Romë dhe në Venecia. Mjafton që laboratoritë të jetë i akredituar dhe të jetë laborator i Bashkimit European dhe funksionon, është 100% në listë.

Genc Pollo – Atëherë, pse nuk na e hapin eksportin e midhjeve?

Roland Kristo – Ta shikojmë kur të vijë këtë vit, sepse kemi bërë kërkesë zyrtare.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, nuk është e vërtetë. Bashkimi European nuk ka ardhur asnjëherë për midhjet, ka ardhur për peshkun.

Arian Palluqi – Hera e fundit ka qenë në vitin 2011, sepse, së paku, kërkohet 3 vjet rresht. Ka një monitorim, pra së paku 2 vjet rresht nga momenti i fundit që janë bërë analizat, ose që janë dorëzuar atje, të mos ketë asnjë nga ato kuadrate. Për shembull, analizat kimike

bëhen çdo 2 javë, analizat e biotoksinave çdo 3 muaj, metalet e rënda e të tjera, pra tek asnjëra nuk duhet të ketë një pullë të kuqe, në të kundërt, duhet të rifillojë, por që nga ai moment duhet të kalojnë dy vjet të tjerë. Kryesisht nuk janë problem as biotoksinat, as metalet e rënda, por problemi është *Coli*, pra një çështje banale. Një burrë që shkon atje, sheh tri lopë në faqen e malit në Butrint dhe pyet: jashtëqitjet e këtyre lopëve i merr shiu dhe i hedh në Butrint? Ku e kanë sistemin e deburimit të ujërave të zeza qytetet e Ksamilit dhe Butrintit? Që ta bëjmë pak më të thjeshtë. Të gjithë ata zotërinjtë vijnë nga Veriu i Europës, se nuk janë mesdhetarë, italianë, spanjollë, megjithatë i ulim në tavolinë dhe ata konsumojnë mirë, se u pëlqen. U thua pastaj se çfarë të keqe ka?! Dhe të thotë atë që ne e kemi parë në filma, “Bukë lepurushi”, pra në vitin 1946 në Korçë ia dha të birit dhe dha urdhër ta hante i gjithë qyteti. Pra, tha që unë nuk shkoj me këtë. Prova biologjike është e domosdoshme. Unë e ndiej, e kuptoj që nuk ju jep asnjë efekt, por e dua me letra, sepse nuk mund të garantoj... Nuk është një prodhim që i mungon BE-së. Nëse do të ishte i tillë, do ta bënim vetë si të donim. Janë një mori faktorësh që ndikojnë te midhja.

Të gjithë kemi qenë buzë detit në Bari, ata i grumbullojnë në natyrë. Pse ju mendojnë se bregu i barit, me ujërat që hedhin restorantet, është më i mirë se Shqipëria? Edhe ai mund të ketë punësuar aty 5 mijë vetë, pra 3 kg njëri, 5 kg tjetri në ditë i dorëzojnë te pikat e grumbullimit. Pra, janë një kompleks faktorësh.

Përgjithësisht, biotoksina, që janë tamam të tmerrshme, metale të rënda e tjera nuk ka. Qëllon një *escherichia coli* që e ka **titrin** më të madh se ç’duhet, që e merr dhe e zien. Ky ka qenë problemi. Në fakt, nuk na preokupon tamam midhja as në sasi dhe as në vlerë se sa të gjitha moluset e tjera që janë në bregdetin shqiptar. Kemi licencuar 5 barka, sa kanë qenë njëherë e një kohë për **telinë, vongola, vëraçim** etj. Ka mbetur problemi i eksportit të gjallë. Megjithatë, shpresoj që, duke kaluar në përpunim, të hapim një herë eksportin për përpunim, pastaj të shohim për atë të gjallin.

Genc Pollo – A u dhanë të gjitha përgjigjet dhe a janë deputetët që bënë pyetjet të kënaqur me përgjigjet? A ka nevojë për pyetje shtesë? Ndoshta, nuk ka mbaruar, se është edhe shqetësimi im për kostot e karburantit.

Roland Kristo – Në fakt, anijet e peshkimit furnizohen me karburant pa taksa. Sot që flasim çmimi, me të cilin anijet e peshkimit e marrin karburantin, është 57 lekë pa TVSH dhe është një nga faktorët që peshkimi zhvillohet. Karburanti merret pa akcizë, pa taksën e karbonit dhe pa taksën e qarkullimit. Sot e ka çmimin 57 lekë pa TVSH. Skema është e tillë: anija e peshkimit e merr karburantin pa taksa, por me TVSH...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

“Kastrati”, “Elda”, pra vetëm firmat e mëdha. Ato shkojnë dhe i furnizojnë me autobot. Kjo procedurë është 100% e kontrolluar nga doganat, pra karburanti i pazhdoganuar, ose karburantit të peshkimit që nuk i janë vendosur të gjitha detyrimet, rri në depozita të veçanta, ngjyroset me një ngjyrues të veçantë dhe menaxhohet nga firmat e mëdha, sipas ligjit për naftën e gazin, dhe janë licencuar firmat e mëdha. Po i them, meqë nuk ka media, “Kastrati”, “Elda”, “Gega”...

Genc Pollo – A ka një bazë ligjore specifike për këtë?

Roland Kristo – Është ligji për akcizat, janë dy VKM nr. 29 dhe nr. 30 të janarit të vitit 2015, është edhe udhëzimi nr. 6 i ministrave të Financave dhe Bujqësisë, që jep detajet e tjera.

Genc Pollo – Cila është mënyra se si përzgjidhen kompanitë grosiste të karburanteve?

Roland Kristo – E zgjedh vetë ai sipas çmimit. Domethënë, peshkatari merr në telefon dhe e pyet për çmimin dhe zgjedh çmimin që i leverdis.

Genc Pollo – Pra, është përzgjedhje e vetë përdoruesit. Megjithatë, këto dy VKM-të dhe udhëzimin mund ta na i dërgoni me postë?

Roland Kristo – Patjetër, udhëzimin nr. 6 dhe VKM-të nr. 29 dhe nr. 30.

Arjan Palluqi – Kam merak që t’i marrë tamam përgjigjet zoti Bumçi. Anijet e peshkimit janë private. Do të ndodhë ai fenomeni që ka ndodhur me makinat tona private. Të gjithë e kemi filluar me makina të përdorura, 2 mijë euro, 1 mijë euro, *Fiat Mirafiori* 130, sot shkojmë blejmë makina të reja te *Volkswagen*. Gjatë gjithë këtyre viteve shteti i ka krijuar kushtet. Ndërkohë që në atë kohë u bënë rrugët dhe sot blejmë makina të reja, ne po i bëjmë portet që të vijnë makina të reja. Megjithatë, dua të them se këta 10 vjetët e fundit flota shqiptare ka së paku rreth 20 anije, që nuk është fare meritë e shtetit, pra është rinovuar me mjete të reja.

E fundit fare, përsëri në kuadër të politikave mbështetëse, është VKM-ja e fundit e një viti më parë e qeverisë për heqjen e të gjitha taksave të TVSH-së për pajisjet *on board*, që përdorin anijet e peshkimit. Si çdo mall, që është *free on board*, nuk vjen fare në tokë, rrjeta e peshkimit, pajisjet elektronike janë të gjitha pa TVSH-ë. Në kuadër të një projekti IPA, që fillon këtë vit në muajin shkurt, është përcaktuar një fond prej 1,5 milionë eurosh në formë granti, 50% me 50% me barkat aplikuese që për çdo ndërhyrje në barkë, 50% do ta ketë falas nga ky projekt. Kjo do të thotë se në total shkojnë 3 milionë euro për të rinovuar kushtet higjeno-sanitare të motorit të anijeve dhe pajisjet elektronike.

Genc Pollo – A ka tjetër gjë për t’ia sqaruar komisionit, para se të kalojmë te një pyetje shtesë?

Arian Palluqi – Si për numrin e barkave, ashtu edhe për sasinë e peshkut, (ka lloje peshkut që nuk mund t’i konsiderojmë një valvul sociale) edhe sikur t’i kemi lekët, edhe sikur të na i falni anije të reja “merrini 100 copë dhe futini në detin Adriatik”, nuk të lënë, sepse e konsiderojnë “*share stocks*”, pra malli im është edhe malli yt dhe ti do të zbatosh po ato politika që zbatoj edhe unë. Ne e kemi të përcaktuar me VKM numrin e anijeve. Fatmirësisht, e kemi përcaktuar numrin, para se të bëheshim anëtarë. E detyron sot ai Italinë. Ata ulin, po demolojnë barka dhe ai i jep çdo barke 100 mijë apo 200 mijë, aq sa kushton. Ne nuk kemi. Ne kemi lënë atë numër. Mbi këtë numër, qoftë për sasinë e anijeve, qoftë për sasinë e peshkut, për lloje të veçanta, duke përfshirë sardele dhe açuke, nuk mund të kalojmë. 220 tonë thotë, që, në fakt, është edhe prodhimi më i mirë që është zënë në vendin tonë, pa marrë në konsideratë se çfarë bëhej para ’90-ës, kur 90% e flotës gjuante vetëm sardele dhe açuke.

Genc Pollo – Po, zonja Tabaku.

Jorida Tabaku – Kërkoj ndjesë, sepse nuk isha që në fillim, por isha në një mbledhje tjetër komisioni. Raporti që ka sjellë Drejtoria e Përafrimit të Legjislacionit thotë se përafrimi i legjislacionit është i pjesshëm. Në fakt, në këtë komision nuk ka qenë ndonjëherë diskutim, të paktën përpara vitit 2013, zbatimi i MSA-zë, sepse për këdo që vinte në pushtet, kur ndërrohej qeverisja, zbatimi i MSA-së ka qenë prioritar për secilën forcë politike. Në fakt, në këto vite kanë qenë disa vendime në shkelje të MSA-së, të cilat lidhen kryesisht me konkurrencën, ligji për teatrin, aeroporti i Vlorës. Qeveria ka nxjerrë një projektligj për konsultim, “Korporata e investimeve shqiptare”, që është përsëri në shkelje të MSA-së. Pra, kemi një praktikë të shkeljes së MSA-së gjatë viteve të fundit. Dua të sigurohem që këtu kemi një përafrim të plotë me MSA-në, të paktën për ata sektorë që kemi mundësi dhe të mos kemi asnjë shkelje. Ju përmendët disa çështje të konkurrencës, prandaj më lindi diskutimi.

Roland Kristo – Thjesht për të bërë një sqarim. E thashë që në fillim se ligji nr. 64/2012 është një ligj modern, i cili është hartuar me asistencën e Bashkimit European. Një nga rregulloret mbi të cilat bazohej ligji i peshkimit ka qenë edhe rregullorja nr. 104 e Këshillit të vitit 2000. Ka qenë kjo një nga pesë rregulloret, mbi të cilën bazohet ligji i peshkimit. Kjo rregullore është shfuqizuar nga BE-ja. Ne këtë pjesë kemi shfuqizuar dhe e kemi zëvendësuar me rregulloren e re. Pjesa tjetër e përfarimit të rregullores përkatëse nr. 1379 është një çështje më komplekse, e cila merret me pjesën, deri edhe të statutit të organizatave të menaxhimit të peshkimit. Nuk mund ta parashikojmë ne në ligj një gjë të tillë. Këto janë pjesë e akteve

nënligjore. Rëndësi ka që neni 61 i ligjit ekzistues, nga një nen i madh është reduktuar në dy rreshta, pastaj janë futur dy nënnene, 61/1 dhe 62/2, që janë përafrime të rregullores specifike.

Jorida Tabaku – Ju faleminderit! E ngrita shqetësimin për moszbatimin e MSA-së për anëtarët e komisionit. Ka nevojë që ne t’i shohim disa fusha. Ndoshta, në këtë rast specifik janë diskutuar dhe do të merren parasysh, por ne si komision duhet t’i shohim disa fusha në të cilat është shkelur MSA-ja, që nuk kishte ndodhur kurrë më parë në asnjë qeverisje. Kërkoj ndjesë, se nuk isha te pjesa e parë e diskutimit, por mendoj se duhet ta adresojmë këtë çështje edhe në një nga seancat në vijim të kalendarit bashkë edhe me kolegët socialistë. Ligji i teatrit, aeroporti i Vlorës dhe ligji i ri që ka nxjerrë qeveria për konsultim përpara 10 ditësh “Korporata e investimeve shqiptare”, ku do t’u jepen prona publike pa proces tenderimi investitorëve specifike, të tria këto janë raste në shkelje të MSA-së dhe mendoj se duhet t’i diskutojmë bashkë. Sigurisht që secili prej nesh këtu bën edhe pjesën politike, por MSA-ja deri tani ka qenë një territor i pashkelur pa asnjë palë politike. Fatkeqësisht ka filluar tani. Kjo nuk ka lidhje fare me peshkimin. Ju pyeta meqenëse e kishte referuar Drejtoria e Përafrimit të Legjislacionit, pra thjesht për t’u interesuar.

Genc Pollo – Po, zonja Spahiu.

Klodiana Spahiu – Zoti Kryetar, faleminderit!

Në fakt, unë kisha vetëm dy gjëra për të sqaruar.

E para, në vazhdim të të gjitha sqarimeve që bëri zoti zëvendësministër, një kërkesë e vazhdueshme e peshkatarëve ka qenë një vend i caktuar për riparimin e anijeve. Ky është një problem që e kanë kudo anijet e peshkimit, sepse paguajnë kosto shumë të larta kur shkojnë në vende të tjera për të riparuar anijet. Shpresoj që kjo gjë do të vlerësohet nga ju për t’u zgjidhur...

(Ndërhyrje pa mikrofoni)

Patjetër. Jua jep kryetari lejen, sepse unë kam edhe diçka tjetër për të thënë.

Genc Pollo – Po, një plotësim të vogël.

Roland Kristo – Neni 11 ose neni 65, pika 3, ne kemi pasur, në fakt, një diskutim me Ministrinë e Financave në lidhje me ndërtimin e shkallëve të riparimit të anijeve. Ne donim që vendi për të ndërtuar shkallët t’i jepej privatit për ta ndërtuar, sepse do të jetë një investim privat me kushtet më lehtësuese të mundshme për anijet e peshkimit, sepse, në fund të fundit, po t’i vë një vlerë shumë të lartë qiraje, natyrisht do të reflektohet në çmimin që do t’i ofrojnë anijeve të peshkimit.

Ka pasur një diskutim për amendimin e VKM-së nr.54/2014, e cila merret me mënyrën e dhënies me qira të pronës shtetërore, Ministria e Financave na sugjeron që, duke qenë se

kërkon politika lehtësuese në lidhje me investimin në fushën e peshkimit bënin një amendim në ligj, të cilin ne e kemi reflektuar te neni 65, pika 3: “Kushtet dhe procedurat e transferimit të menaxhimit të infrastrukturës së peshkimit, te organizatat e peshkimit dhe subjektet private, miratohen me VKM”.

Pra, ne duhet të bëjmë një VKM për mënyrën e dhënies me qira të pjesëve të porteve të peshkimit, me qëllim që të ndërtohet shkallët e riparimit të anijeve.

Në Portin e Shëngjinit kemi dy kërkesa për të ndërtuar shkallët e riparimit të anijeve, dy i kemi në Vlorë (është një firmë italiane dhe një firmë holandeze) dhe një e kemi në Sarandë.

Për momentin, në portin e Durrësit, duke qenë se është porti i ri dhe i vogël, nuk kemi ndër mend, të paktën në Portin e Peshkimit, të ndërtojmë shkallë të riparimit të anijeve.

Klodiana Spahiu – Unë dua të ndaj me ju një problematikë që e ngriti kolegja Gjoshë në lidhje me sistemin blubox. Informacioni që kemi ne si deputetë për këtë gjë është i mangët dhe përfituar nga eksperiencia në Komisionin e Sigurisë, nga të gjitha vizitat që kanë bërë në disa prej institucioneve më të rëndësishme, si në QNOD, në Komandën Detare dhe në Drejtorinë e Kufirit dhe Migracionit, ne kemi marrë një informacion të detajuar në lidhje me këtë sistem dhe çfarë ka ndodhur me të vërtetë dhe si ka funksionuar sistemi blubox. Të gjithë ata punonjës, që punojnë në Komandën Detare, meqë ishit të interesuar për këtë pjesën e mungesës së kohës shumë të shkurtër të sistemit blubox, na janë dhënë të dhëna të caktuara për periudhën 2008-2017. Këto të dhëna disponohen nga Komisioni i Sigurisë dhe nga viti 2013 deri në vitin 2017 sistemi blubox kishte pasur një mungesë në punë për shkak të tenderimit dhe jo të fikjes (për këtë ata mbanin një përgjegjësi, sepse ishin po të njëjtët njerëz që kanë punuar gjithmonë në atë sistem, bëhet fjalë për komandën detare).

Ndërkohë që, para vitit 2013, ky sistem, përsëri nga të dhënat e tyre, kishte munguar për muaj të tërë dhe në të dhëna, kur bëhej shuma, kishte një periudhë të gjatë që nuk kishte punuar sistemi blubox.

Në këtë projektligji bëhet fjalë për anijet e vogla që mendohet se vijnë shumë afër bregdetit dhe nuk kanë mundësi teknike për të kaluar vijën apo për të menduar se këto mund të përdoren për sistem tjetër. Ideja e një errësire totale informacioni që kemi pasur për këto anije është një diferencë e madhe (e thënë kjo nga profesionistët, jo nga politikanët).

(Diskutime pa mikrofon)

Viktor Tushaj – Te ndryshimi i ligjit ju thoni “menaxhimi i infrastrukturës së peshkimit në format e tij. Një pjesë është menaxhim i drejtpërdrejt. Padyshim, ne jemi Komision Integrimi dhe japim mendim për përafrimin e legjislacionit, por besoj se ky

ndryshim ligji për ne si komision, por besoj se të gjithë deputetët janë të interesuar, përafrim legjislativ të ndikojë në përafrimin e standardit me BE-në, pra që të përmirësohen standardet.

Unë marr shkas nga peshkimi në Shëngjin. Atje është jo vetëm larg standardeve, po shumë larg standardeve, sepse akoma ndërmarrja e peshkimit, apo pjesa e peshkimit nuk është e ndarë me portin e Shëngjinit. Anijet e peshkimit, nuk dinë se ku të ankorohen. Ka 3-4 anije që janë mbytur aty dhe pengojnë në mënyrë të jashtëzakonshme ankorimin. E gjithë kjo ka ndikuar në mënyrë të jashtëzakonshme dhe ndërtimi i një infrastrukture mund të bëjë shumë më të lehtë akomodimin, por edhe u jep kurajë gjithë peshkatarëve për të përmirësuar anijet e tyre. Shtojmë këtu edhe një konflikt, një mbajtje kot nga marina të një pjese të detit, i cili nuk shfrytëzohet (janë disa anije të viteve '60 atje, të cilat vetëm pengojnë ndërtimin e një infrastrukture që do të vendosej në shërbim të portit, por edhe në shërbim të ndërmarrjes së peshkimit).

A mendoni se ky ligj i ndryshuar do të ndikojë në përmirësimin e kësaj infrastrukture dhe të përafrimit të standardeve të peshkimit me BE-në?

Roland Kristo – Është e vërtetë ajo që thanë në lidhje me Portin e Shëngjinit.

Ne fakt, flota e peshkimit në Shëngjin është e dyta për nga madhësia, pas flotës së Durrësit (ndoshta jo për numër, por për fuqi peshkuese, sepse janë anijet më të mëdha, të cilat ia kalojnë gati dyfish edhe Vlorës).

Ajo që kemi aktualisht është një pjesë shumë e vogël. Ne shfrytëzojmë edhe pjesë të portit tregtar sh.a. dhe tani jemi në negociata që të marrim një pjesë më të madhe në Portin e Shëngjinit, me idenë që ky port të kalojë në një port peshkimi dhe port turistik.

Duke qenë se ka në pjesën e ushtrisë, nga prapa, atë portin e vogël, ka një projekt që të bëhet port tregtar me tunel, të kalojë direkt, sepse nuk mund të kalojnë makinat e mëdha mes për mes qytetit, sidomos në sezonin e verës (se vetëm për një anije që shkarkon çimento i bie të mbahet gjithë ai port). Pra, ne jemi në negociata me Ministrinë e Transportit që në Portin e Shëngjinit të zgjerohet porti i peshkimit dhe në dy krahët, lart dhe poshtë, të bëhet port turistik. Kjo është pjesa e negociatave që kemi aktualisht me Ministrinë e Infrastrukturës.

Në lidhje me ushtrinë, unë mendoj se anijet që rrinë atje janë të vjetra dhe mund t'i vrasin sytë, por po të shkosh kudo, në çdo port, qoftë edhe në portet jashtë, kur shikon anije të bukura të ushtrisë ose të Rojës Bregdetare është pjesë e atraksionit turistik.

Ndërsa ato anijet që kanë mbetur prapa presim t'i largojnë dhe aty do të bëhet kantieri. Këtë e kanë kërkuar dy subjekte të Lezhës që kanë kërkuar të bëjnë shkallën e riparimit të anijeve.

Senida Mesi – Në fakt, besoj se pyetjet u ezauruan dhe më tepër ky imi është si diskutim. Dua të falënderoj Rolandin, sepse kemi pasur mundësi të bashkëpunojmë edhe në pjesën e procedurave apo deregulimit në shumë aspekte dhe besoj se gjatë një viti e gjysmë, sidomos në fushën e peshkimit, falë edhe njohurive teknike të fushës, besoj që shumë problematika të cilat deri para një viti e gjysmë ekzistonin, sot, qoftë nga ana e procedurave, rregullave apo ligjeve, janë sheshuar.

Na ngelet tani ta shfrytëzojmë maksimalisht për të marrë benefitin si vend (ndoshta të një strategjie kombëtare për peshkimin) dhe t'i vëmë të gjithë këto elemente, me qëllim që jo vetëm ekonomkisht, por edhe në fushën e turizmit të japë vlerën maksimale.

Kam një merak. Kur flasim për përafrim ligji (dhe këtu diskutojmë, sigurisht, ligjin), më pas kemi pjesën e zbatimit të ligjit, aktet normative apo ndonjë rregullore që del me vendim të ministrit, jo detyrimisht kalojnë në Komisionin e Integritetit. Kështu që, do të doja nga ana juaj, që edhe praktikat më të mira të BE-së të implementohet në pjesën e vendimeve apo urdhrave të ministrit, me qëllim që të përfshijë edhe aplikimin për leje peshkimi.

Kam njohuri teknike në lidhje me procedurën e raportimit jo të grosistëve për karburantin, por të anijeve të tjera që blejnë naftë, në lidhje me raportimin në sistemin doganor (një herë në 6 muaj, ishte një herë në tre muaj), pra kemi një seri dokumentacionesh, kur në fund të ditës një anije e vogël që ndoshta nuk e ka as kapacitetin, as aftësinë që ta bëjnë vetë dhe duhet të paguajë dike tjetër e kështu shton kostot, por rrit edhe problematikën.

Në lidhje me pjesën të aplikimit të lejes së peshkimit, sidomos për peshkimin artizanal, nuk e di a është përfshirë edhe pjesa e peshkimit sportiv. Më duket se është hera e parë që ne përfshijmë një element të tillë.

(Diskutime pa mikrofon)

Roland Kristo – E kemi diskutuar dhe përcaktuar (është edhe në faqen *online* peshkimi çlodhës, argëtues dhe turistik)

(Diskutime pa mikrofon)

... po, po edhe për turizmin. Mjafton 5 minuta, ta bëjë pagesën *online*... e keni te pjesa e peshkimit turistik...

Neni 6, “Mjetet që përdoren për peshkimin argëtues dhe mënyra e lëshimit të autorizimit përcaktohen me udhëzim të ministrit”.

Senida Mesi – Po pra, për këtë ishte edhe komenti im, që te ky udhëzim të jenë procedurat lehtësuese...

(Diskutime pa mikrofon)

Roland Kristo – Ne kemi diskutuar me AKSH-in, sepse AKSH-i do ta mbajë faqen, por mungonte fjala “e procedurave”.

Me udhëzim ministri do të ngrihet një faqe *online*, ku të bëhet pagesa *online* dhe anijet që vijnë, sidomos anijet e huaja, jahtet që hyjnë dhe duan peshkim turistik, e bëjnë pagesën *online* dhe automatikisht marrin lejen.

Senida Mesi – Dakord.

Në lidhje me formalizimin është përfshirë një pikë tjetër shtesë në lidhje me objektivin e organizatave prodhuese. Për peshkimin e paligjshëm ne duhet të vendosim sanksione (ndoshta nuk është pjesë e komisionit tonë, por e Komisionit të Ligjeve) jo vetëm për organizatat prodhuese, por për këdo që ka leje. Të ketë edhe masa penalizuese, por edhe një procedurë denoncimi *online*, një mesazh, ku menjëherë të bëhet denoncimi dhe inspektoratet përkatëse të vijnë dhe të bëjnë kontrollin dhe verifikimin, me qëllim që të mos rrimë me “më tha, i thashë”.

Ju e dini që kjo ndodh në dete, por ndodh kryesisht edhe në liqene. Është e turpshme që në liqenet përkatëse (po i referohem liqenit të Shkodrës) nuk gjen asnjëherë sasinë e peshkut apo të llojeve që dikur kanë ekzistuar, vetëm e vetëm prej peshkimit të paligjshëm.

Të falënderoj!

Genc Pollo – Më duket se nuk ka më pyetje dhe diskutime.

Duke u nisur nga peshkimi i paligjshëm, shikoj në relacion se keni shkruar për kontrollin më efikas, për të shmangur peshkimin PPP. Në fakt, më vajti mendja se mos ishte ai akronimi që ka marrë reputacion të keq, por është i paligjshëm, i pazbatuar dhe i parregulluar.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Sa të gjej mënyrën që të kem edhe kuorumin për ta votuar këtë ligj, zonja dhe zotërinj...

Duke dalë pak nga tema e peshkimit, nevoja për të pasur konkurrencë dhe ofertë konkurruese qenka zgjidhur me çështjen e furnizimit. Megjithatë, ju do të jepni të gjitha VKM-të, udhëzimet apo aktet e tjera...

Zonja Tabaku në këtë sens ngriti edhe një shqetësim, që lidhet me punën e komisionit tonë. Pra, janë dy ligje të miratuara, si dhe një projektligj, të cilët shkelin Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit, përveçse frymën e përgjithshme të legjislacionit që ofron.

Zoti Ulqini...

Së pari, ofron garancinë për konkurrencë në treg.

Rasti i parë është ai i ligjit të njohur si ligji i posaçëm “Fusha” për Teatrin Kombëtar, i cili, fatkeqësisht, nuk kaloi në Konferencën e Kryetarëve, për t’u shqyrtuar më pas në komisionin tonë.

Rasti i dytë, i miratuar me procedurë të përshpejtuar, si i pari, ka të bëjë me ndërtimin e aeroportit të Vlorës në shkurt të vitit të kaluar. As ky nuk ka kaluar për shqyrtim në komisionin tonë, në mënyrë që të verifikohet nëse është në përputhje me Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit dhe me *acquis communautaire* në përgjithësi.

Një rast tjetër, që ende është në konsultim publik, pra qeveria ende nuk ka marrë një vendim dhe nuk e ka përcjellë në Kuvend, është ai që u referua nga kolegja Tabaku. Ka të bëjë me krijimin e një konsorciumi publik për investime dhe në procedurat e tij, së pari, nuk parashikohet se si do të merret prona, që mund të mos jetë publike, pra ka hapësirë për arbitraritet, dhe, së dyti, mënyra se si do të jepet ajo është përsëri pa ankand apo pa garë të hapur, që përbën një shkelje të ligjshmërisë në përgjithësi dhe të MSA-së në veçanti.

Në fillim të legjislaturës, në Konferencën e Kryetarëve iu drejtova zotit Ruçi, Kryetarit të Kuvendit, me shqetësimin që disa nisma ligjore të marra nga deputetët nuk i nënshtroheshin verifikimit nëse përputheshin ose jo me MSA-në, sepse supozohet që çfarë vjen nga qeveria i është nënshtruar një kontrolli fillestar dhe duke kaluar në komisionin tonë shikohet nga Njësia për Përafrimin e Legjislacionit nëse është ose jo në përputhje.

Nismat e deputetëve, meqë ishin të tilla, i shmangeshin këtij lloj kontrolli. Zoti Ruçi dha porosi që kjo të korrigjohej në të ardhmen. Megjithatë, duhet të jemi vigjilentë për nisma të tilla nëse do të ketë raste shmangieje.

T’u kthehemi tri rasteve të cituara, të përmendura nga kolegja.

Rasti i ligjit të posaçëm “Fusha” pati një ndërhyrje dhe një amendim. Debatimi për këtë është bërë. Për projektligjin duhet të presim të vijë në program dhe të pastaj të shikojmë se cili është kalendari.

Ndërkohë, ligji për aeroportin e Vlorës është ligj ende në fuqi. Ka qenë objekt i korrespondencës mes meje dhe një kolegu, si dhe Komsionit European, përveç debatit që është bërë në Kuvend, por fatkeqësisht është një ligj në fuqi, për të cilin ne si Kuvend, me instrumentet tona, siç është edhe Njësia e Përafrimit, nuk kemi një opinion teknik nëse është në përputhje me MSA-në ose jo.

Besoj se ky është një problem që duhet ta zgjidhim. Se si do ta zgjidhim, nuk e di, por do të konsultohem me kolegët, ndoshta edhe me Konferencën e Kryetarëve, për të gjetur një zgjidhje.

Kjo ishte në vijim të shqetësimit që u ngrit nga zonja Mesi dhe më herët nga zonja Tabaku për këto tri ligje.

Doja ta ndaja me ju këtë, sepse mendoj që është e rëndësishme.

Tani, le t'i rikthehemi tematikës së rendit të ditës, që ka të bëjë me projektligjin për peshkimin.

Besoj se pyetjet, komentet dhe diskutimet u dhanë. Përgjigjet mendoj se ishin sqaruese...

Ka ndonjë çështje tjetër për të ngritur? Ndonjë koleg që do të flasë?

Fatkeqësisht, disa kolegë nuk e patën mendjen dhe u larguan pa u sinjalizuar se po binim poshtë kuorumit.

Person f – Taulanti nuk mund të vijë tani, është larguar. Nuk e di se kush mund të vijë nga...

Genc Pollo – Nëse ndonjë nga anëtarët mund të vijë, kjo do të na ndihmonte. Përndryshe, do ta kalojmë për votim në datën 4.

(Diskutime pa mikrofon)

Person f – Atëherë, i bie ta kalojmë për votim javën që vjen.

(Diskutime pa mikrofon)

Taulanti lëvizi, Sadriu nuk është...

(Diskutime pa mikrofon)

Genc Pollo - Edhe një herë, për sqarim: vërejtjet e Njesisë së Përafrimit u morën parasysh dhe do t'i miratojmë duke i pasqaruar ato.

Edhe ju bini dakord për këtë?

Hedhim në votim projektligjin “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 64, datë 31.05.2012 , “Për peshkimin”, i ndryshuar”.

Kush është dakord?

Na thoni aty ku ka ndryshime, që ta shpreh.

Neni 1.

Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 2.

Pro? Kundër? Abstenim?

Dedë Kasneci – Ndryshimi i parë, shënimi në fund të faqes, që lidhet me titullin e projektligjit.

Genc Pollo – Jemi te 1-shi apo te 2-shi?

Dedë Kasneci – Tek titulli.

Genc Pollo – Dakord.

Miratohet neni 2.

Kalojmë te neni 3.

Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 4.

Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 5.

Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Zoti Velaj, e keni të qartë qëndrimin? Dakord.

Neni 6.

Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 7.

Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 8.

Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 9.

Këtu ka ndryshime, të cilat... A mund t'i shprehni gojarisht që të mbeten...?

Dedë Kasneci – Te neni 9 i projektligjit, që parashikon të shtohen dy nene, neni 61, pika 1 dhe neni 61, pika 2, ne kemi sugjeruar që pika 2 të bëhet: “parandalojnë dhe zvogëlojnë sa më shumë që të jetë e mundur”. Te formulimi i sjellë nga qeveria ka një lapsus. Është thënë: “parandalojnë dhe zvogëlojnë sa më shumë zëniet e mundshme”, por duhet të jetë “parandalojnë dhe zvogëlojnë sa më shumë që të jetë e mundur zëniet”. Kjo në përputhje me direktivat ...

Genc Pollo – Edhe për gjuhën shqipe është më e ...

Dedë Kasneci – Ndryshimi i dytë është te pika 3 e të njëjtit nen. “Organizatrat prodhuese mund të ndjekin objektiva plotësuese”, është thënë në versionin e ardhur nga qeveria, kurse ne sugjerojmë të bëhet “organizatat prodhuese mund të ndjekin objektiva të tjera plotësuese”.

Këto kisha, zoti kryetar.

Faleminderit!

Genc Pollo – Shumë e kollajtë për të qenë dakord.

E hedhim në votim.

Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet, me ndryshimin e shprehur.

Neni 10.

Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 11.

Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 12.

Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 13.

Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 14.

Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Kalojmë në votimin në tërësi.

Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet dhe i kalon komisionit përgjegjës.

Ju falenderoj dhe takohemi mbledhjen tjetër sipas kalendarit!

MBYLLET MBLEDHJA